

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Shpenzime sigurimi për automjetet”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 98341140-8 – Sherbime sigurimi.
- **Vlera e fondit limit:** **1,823,221** (një milionë e tetëqind e njëzet e tremijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa tvsh.
- Në bazë të nenit 49, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 41 dhe 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit të përlllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është një kërkesë e mbështetur në pikën 4 të nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Ofertuesi duhet të jetë shoqëri sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.

➤ Përjashtohen nga kjo procedurë Brokerat dhe agjentet e sigurimeve.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqese Licencën “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë” ku përfshihen Klasat 3 dhe 10 respektivisht – Sigurimi i mjeteve tokësore dhe sigurimi i përgjegjësive civile nga perdordorimi i automjeteve mbi toke, të leshuara nga Autoriteti i Mbykqyrjes Financiare (AMF).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.3 Shoqëria e sigurimit duhet të ketë pjesë të stafit të saj jo me pak se një vlerësues dëmsh në sigurime, të liçencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, sipas parashikimit të kuadrit ligjor në fuqi.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

1. CV;
2. Kontratë pune (e vlefshme);
3. Licencë e vlerësuesit të dëmit në sigurime (e vlefshme).

***Argumentim:** Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e neni 41 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose”*

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIME TEKNIKE

“Shpenzime sigurimi për automjetet”

Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, duke iu referuar:

- a) Standardeve Kombëtare, që mbështeten në ato Ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, Standardeve Ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga Organet Ndërkombëtare të Standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen Standardeve Kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose Specifikimeve Teknike Kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
- b) Kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh Standardeve Kombëtare ose Ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale.

Grupi i punës duke u bazuar në këto referenca ligjore dhe kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Sigurisë për siguracionin e automjeteve të Shoqërisë ALBCONTROL “Sha.”, paraqiti specifikimet teknike si më poshtë:

A. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SIGURACIONIN TPL & KASKO & KASKO E PJESSHME

Nr.	Lloji i Automjetit	Targa	TPL		KASKO			
			Primi	Dt Mbarimit	Vlera Aktuale 2023	Dt Mbarimit	Kasko e Plotë	Kasko e Pjesshme
1	Volkswagen Phaeton	AA 749 JF		27/04/2024	1,039,500.00			
2	Volkswagen Passat	AA 758 UZ		27/04/2024	322,428.57			
3	Volkswagen Passat	AA 746 JF		27/04/2024	322,428.57			
4	Skoda Octavia	AA 845 HX		14/11/2024				
5	Skoda Superb	AA 571 GF		24/04/2024				
6	Skoda Superb	AA 673 GC		24/04/2024				
7	Skoda Superb	AA 910 CK						
8	Skoda Superb	AA 010 CL		24/04/2024				
9	Renault Traffic	AA 375 FE		02/12/2024				
10	Volkswagen Amarok	AA 962 CU						
11	Volkswagen Amarok	AA 961 CU						
12	Autobus Hyundai	AA 306 MA		23/06/2024	2,232,500.00			
13	Autobus Hyundai	AA 307 MA		21/06/2024	2,232,500.00			
14	Autobus Hyundai	AA 308 MA		21/06/2024	2,232,500.00			
15	Hyundai 130	AA 589 MA		01/07/2024	381,250.00			
16	Hyundai 131	AA 591 MA		01/07/2024	381,250.00			
17	Hyundai 132	AA 592 MA		01/07/2024	381,250.00			
18	Hyundai 133	AA 593 MA		01/07/2024	381,250.00			
19	Hyundai 134	AA 792 MA		01/07/2024	381,250.00			
20	Hyundai 135	AA 793 MA		01/07/2024	381,250.00			
21	Volkswagen Passat	AA 794 MA		01/07/2024	472,750.00			

Total
11,142,107.14

Shënim:

Automjeti me nr. 1 Volkswagen Phaeton AA749JF, Automjeti me nr. 2 Volkswagen Passat AA758UZ, Automjeti me nr. 3 Volkswagen Passat AA746JF dhe Automjeti me nr. 21 Volkswagen Passat AA794MA, do te sigurohen me Kasko të Plotë.

Automjeti me nr. 7 Skoda Superb AA910CK, Automjeti me nr. 10 Volkswagen Amarok AA962CU, Automjeti me nr. 11 Volkswagen Amarok AA961CU, janë siguruar me TPL.

KASKO	
TPL	
TOTALI	

I. SIGURIMI TPL

1. Objekti i sigurimit TPL është sigurimi i përgjegjësive civile të drejtuesit të mjetit motorrik për dëmet që ky drejtues mund ti shkaktojë palëve të treta, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.10076 datë 12.02.2009 **“Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”** dhe Rregullores Nr.53 datë 25.06.2009 **“Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”**.

2. Afati i sigurimit TPL: 1 Vit

3. Autoveturat do të merren në sigurim TPL në afatin kur atyre u përfundon sigurimi ekzistues.

II. SIGURIMI KASKO, duhet të mbulojë dëmtimet e autoveturës në rastet:

1. Përplasje dhe përmbysje të automjetit me një objekt të lëvizshëm ose të palëvizshëm,
2. Rënie e objekteve të tjera mbi autoveturë që si pasojë sjellin dëmtime,
3. Thyerje e dëmtime të xhamave, fenerëve dhe pasqyrave të autoveturës,
4. Dëmtime për shkak te fenomeneve natyrore të tilla si : stuhi, shi, breshër, borë, tufan etj,
5. Dëmtime te autoveturës për shkak të përmbytjeve e vërshimeve,
6. Dëmtime të shkaktuara nga rrufeja, zjarri, eksplozioni,
7. Dëmtimi nga aktet keqdashëse: dëmet qe shkaktohen nga aktet keqdashëse mbi mjetin motorrik të siguruar gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij, duke filluar nga dëmtimet keqdashëse e deri tek dëmtimet dhe akte të tjera përfshirë edhe ato terroriste,
8. Dëmtime në parkim (pa autor) : dëmet që pëson mjeti motorrik gjatë qëndrimit i parkuar diku dhe nuk dihet shkaktari i dëmit,
9. Vjedhja e autoveturës,
- 9/1. Vjedhja, tentativë për vjedhje: dëmet që vijnë si pasojë e veprimeve të përvetësimit në mënyrë të fshehtë të mjetit motorrik të siguruar, nga një ose disa persona i të gjithë automjetit (

vjedhje totale) ose i disa pjesëve të tij (vjedhje e pjeshme). Në këtë rrezik përfshihen gjithashtu edhe dëmet si pasojë e veprimeve që kanë synuar vjedhjen e mjetit motorik por që nuk kanë arritur të kryhen,

10. Territori: Shqipëri,

11. Në llogaritjen e dëmit të autoveurës, Shoqëria e Sigurimit ti referohet çmimeve të pjesëve të këmbimit të Serviseve të autorizuara dhe koncesioneve të autoveurave,

12. Afati i sigurimit KASKO 1 vjeçar. Fillimi i sigurimit KASKO do te jetë afati i përfundimit të sigurimit KASKO ekzistues.

III. SIGURIMI KASKO I PJESSHËM, duhet të mbulojë dëmtimet e autoveurës në rastet:

1. Përplasje dhe përmbysje të automjetit me një objekt të lëvizshëm ose të palëvizshëm,

2. Rënie e objekteve të tjera mbi autoveurë që si pasojë sjellin dëmtime,

3. Thyerje e dëmtime të xhamave, fenerëve dhe pasqyrave të autoveurës,

4. Dëmtime për shkak te fenomeneve natyrore të tilla si : stuhi, shi, breshër, borë, tufan etj,

5. Dëmtime te autoveurës për shkak të përmbytjeve e vërshimeve,

6. Dëmtime të shkaktuara nga rrufeja, zjarri, eksplozioni,

7. Dëmtimi nga aktet keqdashëse: dëmet qe shkaktohen nga aktet keqdashëse mbi mjetin motorik të siguruar gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij, duke filluar nga dëmtimet keqdashëse e deri tek dëmtimet dhe akte të tjera përfshirë edhe ato terroriste,

8. Dëmtime në parkim (pa autor) : dëmet që pëson mjeti motorik gjatë qëndrimit i parkuar diku dhe nuk dihet shkaktari i dëmit,

9. Territori: Shqipëri,

10. Në llogaritjen e dëmit të autoveurës, Shoqëria e sigurimit ti referohet çmimeve të pjesëve të këmbimit të Serviseve të autorizuara dhe koncesioneve të autoveurave,

11. Afati i sigurimit KASKO i pjesshëm 1 vjeçar. Fillimi i sigurimit KASKO i pjesshëm do te jetë afati i përfundimit të sigurimit KASKO ekzistues.

TERMAT E REFERENCËS

Shoqëria e sigurimit do të marrë përsipër sigurimin e autoveurave në përputhje me legjislacionin në fuqi, Udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave, Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si psh: Ligji Nr.10076 datë 12.02.2009, **“Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”**, Rregulloren Nr.53 datë 25.06.2009 **“Për Trajtimin e Dëmeve që Mbulohen nga Kontrata e Sigurimit të Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”**, etj.

Shoqëria e sigurimit ka të drejtën e shitjes së produkteve: Sigurim TPL, KASKO dhe KASKO e pjeshme

Sigurimi TPL i autovegurave do të bëhet me grupe sipas afatit të përfundimit të sigurimit ekzistues të tyre.

Sigurimi vullnetar KASKO do të bëhet për një afat 1 vjeçar. Sigurimi do të jetë KASKO i plotë dhe i pjesshëm. Fillimi i sigurimit do të jetë afati përfundimtar i sigurimit KASKO ekzistues.

Sigurimi KASKO dhe KASKO i pjesshëm është i vlefshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria e sigurimit duhet ti njoftojë palës së dëmtuar të drejtat e detyrimit të saj në lidhje me trajtimin e dëmit.

Shoqëria në rast aksidenti duhet të paguajë shpenzimet e transportit për autovegurën (kur autovegura nuk është në gjëndje të lëvizë) dhe të personave që ndodhen në të.

Fotot e autovegurës së dëmtuar dhe ekspertiza e vlerësimi i dëmit do të bëhen në “ALBCONTROL” SHA.

Vlerësimi i dëmit të bëhet në prani të ekspertit të Shoqërisë dhe përfaqësuesit të “ALBCONTROL” SHA. Vlerësimi i dëmit të bëhet në përputhje me “Manualin e çmimeve “ në fuqi. Vlera e dëmit të llogaritet duke u bazuar në çmimet e pjesëve dhe tarifave të riparimit të serviseve të autorizuara të koncensionarëve.

Shoqëria është e detyruar ti paguajë të dëmtuarit vlerën e dëmit ose të kryejë riparimin e autovegurës në një servis të specializuar me licensë e të regjistruar në organet tatimore.

Veprimet financiare për ç’ dëmtimin e dëmit të autovegurës me “ALBCONTROL” SHA do të bëhen vetëm me Urdhër Xhirimi.

Afati i kalimit të vlerës financiare të dëmshpërblimit për dëmin e autovegurës nuk duhet të jetë më tepër se një muaj.

Çdo problem dhe mosdakortësi mes palëve do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt, zgjidhja e tyre të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Tabela në pikën A të këtij proces-verbali duhet plotësuar me çmimet.